

Linja për mbështetje për COVID-19 për të moshuarit

Linja për mbështetje për COVID-19 për të moshuarit informon, mbështet dhe lidh të moshuarit e Australisë.

Disa të moshuar janë të cenueshëm ndaj COVID-19 por janë edhe më pak të lidhur me internet dhe kanë nevojë për mënyra të qasjes së informacioneve për rrethanat e tyre. Linja për mbështetje për COVID-19 për të moshuarit siguron informacione dhe mbështetje.

Të moshuarit e Australisë, familjet e tyre, miqtë dhe kujdestarët mund në THIRRIN FALAS në 1800 171 866 nëse ata:

- dëshirojnë të bisedojnë me dikë në lidhje me kufizimet për COVID-19 dhe ndikimi i tyre mbi ata
- ndjehen të vetmuar apo janë të brengosur për të dashurit e tyre
- kujdesen për dikë dhe kanë nevojë për informacione apo për të biseduar
- kanë nevojë për ndihmë apo këshillë për ndryshimin e shërbimeve që i marrin për të moshuarit
- kanë nevojë për ndihmë për t'u qasur shërbimeve apo furnizimeve esenciale siç është shoppingu
- janë të shqetësuar për veten, për një mik apo anëtar të familjes që jeton me demencë
- dëshirojnë të caktojnë një kontroll të njehershme apo të rregullt të shëndetit për vete, apo për dikë tjetër.

Të moshuarit e Australisë, familjarët e tyre, kujdestarët, miqtë apo mbështetësit mund të:

- thirrin **1800 171 866**
- 8.30am – 6pm AEST gjatë ditëve të punës
- për çfarëdo informacioni apo shërbimi për të cilin mund të kenë nevojë.

Linja për mbështetje për COVID-19 për të moshuarit është një iniciativë e përbashkët e:

- COTA Australia,
- Dementia Australia,
- Seniorët kombëtar (National Seniors) dhe
- OPAN,
- e mbështetur me financim nga Qeveria e Australisë.

Mbështetje nga Shërbimi për Përkthim dhe Interpretim (TIS)

Të moshuarit e Australisë që nuk flasin anglisht mund të:

- thirrin TIS kombëtar në 131 450,
- kërkojnë një përkthyes, dhe
- kërkojnë të vendosen në Linjën për mbështetje për COVID-19 për të moshuarit apo të citojnë numrin e telefonit 1800 171 866 për t'u lidhur.